

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është lideri më i paguar në botë që merr 7-fishin e pagës së Donald Trump
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/kush-eshte-lideri-me-i-paguar-ne-bote-qe-merr-7-fishin-e-pages-se-donald-tr-i585028
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 17:09:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 17:50:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bd7e29056da38690033b9bec8f2fc2c61ac8ac9923182ff6d19ba5f485f63516
TEKSTI	13ff973a2a3b64cc23c0dd959c8788d0734baf450a57e94eda659b5889700e3e
PAMJA	df63c2fa95e44a8a88f9760ff8f684d6232214225d7f2999949d55d36aef6c8f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	abc8d756d75b181f84f58864891726ccc44357260ad5aef150a156ad830992bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/abc8d756d75b181f84f58864891726ccc44357260ad5aef150a156ad830992bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e 37 mi je ha tokë e djegur nga zjarret këtë verë, dy here më pak se vjetSPAK, merr të pandehur Ballukun për korrupsion pasiv fshehje të pasurisë dhe pastrim të produkteve të veprës penaleLegalizimi fundit

Kush është lideri më i paguar në botë që merr 7-fishin e pagës së Donald Trump

9 Shtator 2026, 19:50Bota TEMA



 Kush është lideri më i paguar në botë që merr

Kryeministri i Singaporit, Lawrence Wong, pritet të thellojë edhe më tej diferencën mes pagës së tij dhe asaj të shumë liderëve të tjerë botërorë, pasi qeveria e vendit ka vendosur të rishikojë ndjeshëm pagat e zyrtarëve politikë.

Wong njoftoi në Parlament se pagat e ministrave do të rriten, pas 15 vitesh që ato kanë mbetur të pandryshuara.

Me reformën e re, paketa vjetore e pagës së kryeministrit do të arrijë në 3.6 milionë dollarë Singapori, rreth 2.85 milionë dollarë amerikanë, nga 2.2 milionë dollarë Singapori që ishte më parë.

Paketa përfshin pagën dhe komponentë të ndryshëm shpërblyes, ndërsa Wong ka deklaruar se do ta dhurojë të gjithë rritjen e pagës së tij për bamirësi për një periudhë pesëvjeçare, nëse vijon të jetë kryeministër.

Mbi katër herë më shumë se paga e presidentit zviceran

Diferenca bëhet edhe më e dukshme kur paga e kryeministrit të Singaporit krahasohet me atë të liderëve të vendeve të tjera.

Paketa e re e Wong është më shumë se katër herë më e lartë se paga e presidentit të Zvicrës dhe rreth shtatë herë më e madhe se paga vjetore prej 400 mijë dollarësh që merr presidenti i Shteteve të Bashkuara.

Sipas një krahasimi të bazuar në kurset e këmbimit në dollarë amerikanë, paketa prej 3.6 milionë dollarësh Singapori është më e lartë edhe se pagat totale statutores të liderëve të SHBA-së, Zvicrës, Australisë, Kanadasë, Koresë së Jugut dhe Zelandës së Re të marra së bashku.

Megjithatë, ky krahasim nuk përfshin domosdoshmërisht bonuset, përfitimet dhe komponentë të tjerë të kompensimit që mund të marrin liderët në vende të ndryshme, ndaj të ardhurat reale mund të ndryshojnë.

Si funksionon modeli i pagave në Singapor?

Sistemi i pagave politike në Singapor është ndërtuar mbi idenë e lidhjes së kompensimit të zyrtarëve publikë me të ardhurat në sektorin privat.

Sipas Divizionit të Shërbimit Publik, paga e një ministri të ri, në kategorinë MR4, përcaktohet duke marrë si referencë të ardhurat e 1,000 qytetarëve me pagat më të larta në vend. Mbi këtë shumë aplikohet një ulje prej 40%, për të reflektuar parimin se shërbimi publik nuk duhet të paguhet në të njëjtin nivel me sektorin privat.

Pas reformës, paga referuese MR4 do të rritet nga 1.1 milion dollarë Singapori në 1.8 milionë dollarë. Kryeministri merr dyfishin e kësaj page referuese.

Qeveria argumenton se një sistem i tillë synon ta bëjë shërbimin publik konkurrues me sektorin privat, veçanërisht me sektorët financiarë dhe të biznesit, ku profesionistët me eksperiencë mund të kenë të ardhura shumë të larta.

Autoritetet e Singaporit e përshkruajnë sistemin si një model “page të pastër”, pa përfitime të fshehura apo privilegje të tjera të veçanta. Një zyrtar politik merr një pagë të përcaktuar, pavarësisht numrit të portofoleve që mbulon.

Rritja nuk do të jetë e menjëhershme për të gjithë ministrat

Rritja e pagës referuese MR4 nuk do të thotë se të gjithë ministrat do të kalojnë menjëherë në nivelin e ri të pagës.

Wong sqaroi se zyrtarët aktualë politikë do të marrin një rregullim fillestar deri në 9%, duke nisur nga 15 tetori. Masa e rritjes do të varet nga faktorë të tillë si performanca e secilit zyrtar dhe koha kur është bërë rishikimi i fundit i pagës së tij.

Kështu, një ministër që aktualisht paguhet 1.1 milion dollarë Singapori mund ta shohë fillimisht pagën vjetore të rritet në rreth 1.2 milionë dollarë, në vend që të kalojë menjëherë në nivelin e ri prej 1.8 milionë dollarësh.

Rritjet e mëtejshme do të përcaktohen në bazë të performancës dhe përgjegjësiqe që mbart secili zyrtar.

Vetë kryeministri Lawrence Wong pranoi se çështja e pagave të politikanëve është veçanërisht e ndjeshme në Singapor.

“Pagat politike janë një çështje e vështirë dhe e tensionuar”, deklaroi Wong në Parlament, duke pranuar se “këto shuma janë më të larta se ato që fitojnë shumica e qytetarëve”.

“E kuptoj pse singaporianët po e shqyrtojnë me kujdes çështjen dhe pse shumë prej tyre kanë ndjenja të forta për të”, shtoi ai.

Megjithatë, kryeministri mbrojti sistemin dhe mënyrën e përcaktimit të pagave, duke theksuar rëndësinë e transparencës.

“Ne kemi një sistem të hapur dhe besojmë se duhet të jemi transparentë në lidhje me pagat e ministrave”, tha Wong, duke nënvizuar se debati nuk mund të shmanget vetëm sepse tema është politikisht e vështirë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

['Uau', Trump festoi fitoren e AfD-së në Gjermani, kancelari Merz anulon telefonatën me presidentin amerikan](#)

18:40 Bota

[Burnham: Mbretëria e Bashkuar do të jetë e palëkundur në mbrojtjen e Ishujve Falkland](#)

18:20 Bota

[Republikanët vendosin myslimanët në qendër të fushatës për zgjedhjet e mesmandatit në SHBA](#)

17:20 Bota / 3 komente

[Greva paralizon Holandën: Transporti publik pezullohet për shkak të shkurtimeve të përfitimeve sociale](#)

16:40 Bota / 1 koment

[Një tjetër pengesë në integrimin e Ukrainës drejt BE, Hungaria vendos një tjetër veto](#)

16:30 Bota / 3 komente

[Nga “magnet votash” në rrezik elektoral, Trump sfidon sondazhet dhe kundërshtarët](#)

16:10 Bota / 3 komente

[LNG, në “grackën” e Hormuzit - Katari dhe Emiratet kërkojnë rrugë alternative. Eksportet bien, kostot e transportit rriten](#)

15:50 Bota

[Zemërim pas raportit të 7 tetorit, Netanyahu përgjigjet me padi ndaj gazetës izraelite](#)

15:40 Bota / 1 koment

[Merz: AFD mbështet politika sinonim të spastrimit etnik](#)

14:30 Bota / 4 komente

[Britani, rinisin fluturimet: Disa aeroporte ishin bllokuar pas defektit në kontrollin e trafikut](#)

14:10 Bota

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 54 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

17:35 Politika / 130 komente

[Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...](#)

14:50 Politika / 10 komente

[Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...](#)

22:50 Kronika / 6 komente

[Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...](#)

19:40 Politika / 125 komente

Blog Tema

[Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?](#)

17:30 Blog

[Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...](#)

13:00 Blog / 14 komente

[Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat](#)

09:45 Blog / 4 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.





Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.